



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 73

Prishtinë, më 18 mars 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Mufera Şinik, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Armend Shkoza – LVV; Vlora Marmullakaj – EULEX; Artan Canhasi – EULEX; Lumniye Murati – ZPRK; Petrit Hysaj – OSBE; Visar Smajlaj – ekspert; Burbuqe Berisha dhe Rebeka Maliqi – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.2.2013;
3. Përfundimi i Kryesisë së Kuvendit nr. 04-P-143;
4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin 04/L-184 për administrimin e punës në zyrë;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.2.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 25.2.2013, pa vërejtje

3. Përfundimi i Kryesisë së Kuvendit nr. 04-P-143

Kryetari – I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, për debat parlamentar për tjetërsimin e pronës publike. Tha se sa i përket kushtetutshmërisë formalo-juridike, mund të mbahet debat, ndërsa ne nuk mund të paragjykojmë se çka do të sjellë në fund ky debat. Mendoj se kjo rezolutë nuk ka fuqi që të ndryshojë të gjitha aktet juridike dhe ndryshimin e situatës, sa i përket të drejtave pronësore.

Arsim Bajrami - Tha se Komisioni për Legjislacion e vlerëson bazën kushtetuese dhe ligjore të çdo dokumenti që duhet të miratohet. Në vazhdim vlerësoi se Kryesia e Kuvendit e bën një lloj verifikimi të çështjeve për t'i prezantuar në mbledhje plenare. Kjo lidhet edhe me debatin e fundit, ku deputetët u gjenden para aktit të kryer, sepse Kryesia mori vendim për një debat, mirëpo paraprakisht është dashur që Komisioni për Legjislacion, ta japë mendimin për bazueshmërinë ligjore dhe kushtetuese. Si duket, Kryesia së Kuvendit i duhet vetëm aspekti formal. Në këtë rast, aspekti formal është i plotësuar, ndërsa në aspektin politik e përkrah plotësisht këtë debat, mirëpo te aspekti ligjor që do të prodhojë ky debat, nuk mund të arrihen efekte juridike me këtë rezolutë. Rezoluta është akt nënligjor, eventualisht mund të jetë bazë që të kërkohet miratimi i një ligji shumë special, të veçantë, për pavlefshmërinë e të gjitha kontratave në të cilat janë tjetërsuar titullarët e pronave. Duke i dhënë përkrahje këtij debati, sugjeroi që krahas rezolutës, apo me rezolutë, të jetë një kërkesë eksplicite që kjo çështje të trajtohet me ligj të veçantë. Në Kosovë, që nga viti 1989 e deri tek periudha e pasluftës, në aspektin pronësor të ndërmarrjeve publike dhe transaksionale ekonomike, ishin ligje të Serbisë të rrethanave të jashtëzakonshme në kohën e spastrimit etnik. Lëvizja Vetëvendosje duhet ta iniciojë këtë ligj dhe të kërkojë që të gjitha efektet juridike të këtyre transaksioneve, të shpallen të pavlefshme.

Armend Zemaj – Theksoi se Kryesia e Kuvendit qëmoti është dashur ta bëjë një veprim të tillë, për arsye të shumta që kanë ekzistuar deri më tani, jo vetëm me mocione, interpelanca, por edhe me nxjerrje të rekomandimeve të cilat trajtohen nga komisionet funksionale. Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe Komisioni për Legjislacion do ishte mirë që të vendosin disa baza që mos të ekzistojnë dilemat në seancën plenare, lajthitje ose edhe një degradim i Kuvendit në përgjithësi. Do të ishte një përlule e Kuvendit, nëse deputetët nuk do të merrnin pjesë për një çështje kaq të rëndësishme. Mendoj që Kuvendit të Kosovës i ka munguar një debat i tillë, i cili është dashur qysh më herët të mbahet, edhe pse në vitin 2003 është miratuar një rezolutë e ngjashme dhe kjo rezolutë shkon edhe më gjerë ku thotë se të gjitha vendimet dhe aktet nënligjore që kanë të bëjnë me procesin e kontratave publike. Ai ndër të tjera foli edhe për çështjen e ndërmarrjeve shoqërore, të cilat janë atakuar edhe nga aspekti legal dhe janë bërë pjesë e protestave publike të qytetarëve, si ai i Deçanit. Këtu është një neglizhencë e AKP –së e transformuar në AKM, sepse në kohën e atakimit në Gjykatën e Supreme, Zyra Ligjore e AKP – së, nuk ka bërë asnjë ankesë ku edhe na bënë të kuptojmë se është duke u fshehur diçka më shumë se që ne po e shohim. Mendoj që kjo rezolutë duhet të rishikohet edhe në aspektin legal. Jam i tharë i asaj që edhe vetë Komisioni, së bashku me Qeverinë, ta marrë përgjegjësinë që ta hartojë një ligj për rishikimin e shumë pronave, jo vetëm në Komunën e Deçanit, por edhe në pjesë tjera, si dhe duhet gjetur një zgjidhje në favor të qytetarëve. Jam për zhvillimin e debatit dhe të kemi rekomandime të qarta për Qeverinë, por edhe për AKP-në si organ i themeluar nga Kuvendi.

Albulena Haxhiu – Tha se pajtohet me parafolësin për sa i përket vendimit të Kuvendit të vitit 2003, për shfuqizimin e të gjitha akteve ligjore dhe juridike që kanë të bëjnë me diskriminimin. Lëvizja Vetëvendosje, përmes këtij debati parlamentar për çështjen e shpronësimit politik të pasurisë kombëtare të popullit të Kosovës, synon që si rezultat i këtij debati parlamentar, Kuvendit t'i shprehë vullnetin e tij ligjvënës lidhur me shpalljen e pavlefshmërisë të të gjitha kontratave, me të cilat është tjetërsuar prona publike dhe ajo shoqërore. Pra, kjo pronë me karakter publik, është njohur si pasuri e punëtorëve të Kosovës, qoftë me ligjin që ishte në fuqi, konkretisht ligji për punën e bashkuar të vitit 1976 dhe ligji për ndërmarrjet i vitit 1989, qoftë edhe me legjislacionin në fuqi, që konsiderohet pjesë e Republikës së Kosovës, e që nënkupton pacenueshmërinë dhe tjetërsimin e pronës shoqërore, që është në kundërshtim me interesin publik. Në ligjin që ishte në fuqi, prona shoqërore ishte dhënë në shfrytëzim punëtorëve shoqërorë ku ata me punën e tyre, do t'i arrinin interesat socio- ekonomike. Rezoluta e Lëvizjes Vetëvendosje ka për qëllim shpalljen e pavlefshmërisë absolute të kontratave që kanë karakter publik. Ndër të tjera, ajo tha se me nxjerrjen e Rregullores së UNMIK-ut 1999/01, e amendamentuar me Rregulloren 1999/24, ku thuhet se juridiksioni i Serbisë për territorin e Kosovës ka përfunduar së zbatuari nga 10 qershori 1999. Rezoluta si akt autentik i Kuvendit, nuk ka fuqi obliguese. Kjo e vërteton më së miri me mbishkrimin e termit që i bëhet rezolutës në shtojcën e Rregullores së punës së Kuvendit, ku me rezolutë nënkuptohet akti ku Kuvendi shpreh vullnetin e tij. Në njëfarë mënyre e bën detyruese këtë rezolutë. Lëvizja Vetëvendosje, pas debatit do të ketë edhe diskutime të tjera me shefat e grupeve parlamentare.

Ardian Gjini – Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve, tha se kjo çështje duhet të rregullohet me ligj, e jo me rezoluta. Kjo mund të ketë edhe efekte tjera, sepse nuk po flasim vetëm për Deçanin, por edhe për fusha tjera. Ai mori shembull ndërmarrjen “Ereniku” që ka qenë gjigant i Ballkanit dhe i është aneksuar Bambi të Pozharevcit, si dhe është bërë pronë e Bambi. Kjo rezolutë nuk është kundërkushtetuese. Arsyeja e kthimit të kësaj rezolute te Komisioni për Legjislacion nga ana e Kryesisë së Kuvendit, ka qenë se teksti i kësaj rezolute mund të nxjerrë edhe efekte të tjera, ndërsa ne si Komision, nuk kemi të drejtë që Lëvizjes Vetëvendosje t'i themi që mos ta mbajë këtë debat parlamentar. Ne mund të kërkojmë nga Qeveria dhe Kuvendi që ta nxjerrin një ligj, sepse me rezolutë nuk mund të shfuqizohen ato vendime.

Behar Selimi – Tha se në Kuvend mund të debatojmë çdo gjë, edhe pse kohëve të fundit është krijuar përshtypja që disa tema nuk kemi të drejtë t'i debatojmë, por kjo thënie është e papranueshme. Sa i përket debatit, tha se e përkrah fuqishëm, mirëpo ka dilema edhe juridike, edhe politike. Ne po flasim për aktet juridike në periudhën e okupimit. Nuk është keq që të diskutohet lidhur me përpilim e rezolutës. Po e përsëris se rezoluta është akt politik, me të cilin artikullohet një vullnet politik i legjislacionit, i cili i kryen obligacionet politike të Qeverisë. A do ta zbatojë atë obligacion Qeveria, varet prej raportimit të forcave në Kuvend.

Kryetari – Tha se kemi dy vullnete lidhur me rezolutën. E para është që ekzistojnë kushtet formale juridike dhe të mbahet debati për këtë çështje dhe vullneti i dytë është që kjo rezolutë të harmonizohet dhe të merret në konsideratë mundësia e rregullimit me ligj.

Ardian Gjini – Propozoi që përfundimi i Komisionit të jetë se kërkesa e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për debat parlamentar, është në pajtim me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse ne nuk mund ta ndryshojmë tekstin e propozim-rezolutës.

Haki Demolli – Ne kemi parë një dokument që na e ka dërguar Kryesia, për ta shikuar bazën ligjore të propozuesit të rezolutës. Mendoj se në aspektin formal juridik, ky propozim i Lëvizjes Vetëvendosje për debat parlamentar, i plotëson kushtet ligjore. Kurse për përmbajtjen e rezolutës, le të vendoset në mbledhjen plenare.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, në mënyrë unanime, nxori këtë

Përfundim

Komisioni për Legjislacion vlerëson se kërkesa e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për debat parlamentar, është në pajtim me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin 04/L-184 për administrimin e punës në zyrë

Komisioni e shqyrtoi Projektligjin për administrimin e punës në zyrë dhe vlerësoi se Projektligji nuk është në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm. Vërejtje u paraqiten në raportin e Komisionit FunkSIONAL lidhur me mënyrën e procedimit të vërejtjeve gjuhësore, të propozuara nga Grupi Parlamentar – SLS dhe e vlerëson si të nevojshme që Drejtoria për Standardizim, Përafrim dhe Harmonizim Ligjor duhet të këtë parasysht që vërejtjet e propozuara nga Grupi Parlamentar –SLS, të jenë në harmoni me versionin e Projektligjit në gjuhën shqipe.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Projektligjin nr. 04/L- 184 për administrimin e punës në zyrë, nuk është në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Komisioni paraqet vërejtjet në raportin e Komisionit FunkSIONAL lidhur me mënyrën e procedimit të vërejtjeve gjuhësore, të propozuara nga Grupi Parlamentar - SLS.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë

Kryetari – Propozoi që në preambulën e Projektligjit, të hiqet referenca në nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Propozimi u përkrah nga anëtarët e Komisionit, dhe meqë nuk kishe vërejtje tjera, *kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, në mënyrë unanime, nxori këtë*

Përfundim

1. Projektligji 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. I sugjerohet Komisionit FunkSIONAL, që në preambulën e Projektligjit, të hiqet referenca në nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:10.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi